

FLETËPALOSJE - INFORMACION PËR PËRDORUESIT

ALRINAST 2.5mg/5ml Shurup



Për përdorim nga goja

- **Principi aktiv:** 0.5 mg desloratadine për 1 ml
- **Eksipientë:** Sukrozë, glikol propilene, sorbitol (70%), benzoat natriumi, citrat dihidrat natriumi, acid anhidrik limoni, edetat disodium, FCF të verdhë, shije frutash, ujë i dejonizuar

Lexoni me kujdes te gjithë këtë fletëpalosje para se të nisni përdorimin e këtij bari, sepse përmban informacion të rëndësishëm për ju.

- *Mbajeni këtë fletëpalosje. Mund të keni nevojë ta lexoni sërish.*
- *Nëse keni ndonjë pyetje të mëtejshme, konsultoni mjekun tuaj ose farmacistin.*
- *Ky bar është përshkruar vetëm për ju, mos ua sygjeroni personave të tjerë.*
- *Informoni mjekun tuaj që jeni duke u trajtuar më këtë bar, në rast se bëni vizitë tek mjeku ose jeni në spital.*
- *Ndiqni rreptësisht udhëzimet në këtë fletëpalosje informative. Mos përdorni doza më të larta ose më të ulëta, përveç se ajo që është rekomanduar për ju.*

Në këtë fletëpalosje:

- 1. Çfarë është ALRINAST dhe përse përdoret?**
- 2. Përpara se të përdorni ALRINAST**
- 3. Si ta përdorni ALRINAST?**
- 4. Efektet e mundshme anësore**
- 5. Si të ruani ALRINAST?**

Janë përfshirë.

1. Çfarë është ALRINAST dhe përse përdoret?

ALRINAST është shurup që gjendet në flakonë/shishe 150 ml me një lugë matëse, në masat 2, 2.5 dhe në 5 ml.

ALRINAST, është një bar antialergjik, që nuk ju jep përgjumje. Bari ndihmon për të kontrolluar reaksionin alergjik dhe simptomat e saj.

ALRINAST qetëson simptoma të tilla, si tështitje, hundë që rrjedhin ose të irrituara, qiellzë të pezmatuar, sy të kuq, të përlotur apo të irrituar [për shembull, pollinosis / (hay fever), ose alergji prej insekteve, pluhurit] lidhur me rinitet alergjike

ALRINAST është përdorur edhe për eliminimin e simptomave të tilla të shoqëruar me urtikarie, ënjtje dhe skuqje të lëkurës

Qetësimi i këtyre simptomave zgjat përgjatë gjithë ditës, dhe trajtimi me këtë bar, ju ndihmon për të rifituar veprimtarinë tuaj normale të përditshme si dhe dhe gjumë të qetë.

2. Përpara se të përdorni ALRINAST

MOS PËRDORNI ALRINAST

Nëse;

- Ju keni mbindjeshmëri (alergji) ndaj desloratadinës, loratadinë apo ndonjë nga përbërësit e tjerë të këtij bari, veçanërisht ndaj ngjyruetit FCF i verdhë.

ALRINAST është i rekomanduar për fëmijët nga mosha 6 muaj deri 11-vjeç , në adoleshentët (12 vjeç e sipër) dhe të rriturit, përfshirë të moshuarit gjithashtu.

PËRDORENI ALRINAST ME KUJDES në kushtet e përcaktuara më poshtë;

- Nëse keni funksion të dobët të veshkave.

Nëse, ndonjë prej këtyre paralajmërimeve përputhet me gjendjen tuaj të tanishme, apo me çdo periudhë në të kaluarën, ju lutemi të konsultoheni me mjekun tuaj.

Përdorimi i ALRINAST me ushqim dhe pije

ALRINAST mund të merret me ushqim ose esëll.

Shtatzënia:

Përpara se të merrni këtë bar, konsultohuni me mjekun tuaj ose farmacistin.

Mos e merrni ALRINAST, nëse jeni shtatzënë.

Në rast se, ju vini re se jeni shtatzënë gjatë terapisë suaj, konsultohuni me mjekun tuaj menjëherë.

Ushqyerja me gji:

Përpara se të merrni këtë bar, konsultohuni me mjekun tuaj ose farmacistin.

Mos e merrni ALRINAST gjatë periudhës së ushqyerjes me gji.

Drejtimi dhe përdorimi i makinerive

Në dozën e rekomanduar të ALRINAST, nuk pritët t'ju shkaktoj përgjumje apo mosvëmendje. Megjithatë, shumë rrallë, disa pacientë mund të perjetojnë përgjumje. Kjo mund të ndikojë në aftësinë për të drejtuar makinën apo përdorimit të makinerive.

Informacion i rëndësishëm në lidhje me disa përbërës të ALRINAST

ALRINAST përmban ëmbëlsues/sukrozë dhe sorbitol. Nëse ju është thënë nga mjeku juaj, që keni intolerancë për lloje të caktuara të sheqerit, kontaktoni me mjekun tuaj para se të merrni këtë produkt.

ALRINAST përmban FCF të verdhë si ngjyruës. Kjo mund të shkaktojë reaksione alergjike.

Ky produkt mjekësor përmban më pak se 1 mmol (23mg) natrium në çdo dozë; por si rjedhje asnjë efekt anësor nuk është parashikuar.

Produkti mjekësor përmban 100 mg / ml gliko propilen. Nuk priten efekte anësore për shkak të gliko propilenit për këtë dozë.

Përdorimi i barnave të tjera

Nuk ka ndërveprime të njohura të ALRINAST me barna të tjera

Në qoftë se aktualisht, apo së fundmi, merrni, ose keni marrë ndonjë bar të përshkruar me ose pa recetë, ju lutem informoni mjekun ose farmacistin tuaj

3. Si ta përdorni ALRINAST?

Udhëzime për përdorimin e duhur dhe shpeshtësinë e dozës

Fëmijët e moshës: 6 deri 11 muaj: 2 ml shurup një herë në ditë. Përdorni lugën matëse deri në 2 ml.

Fëmijët e moshës: 1 deri në 5 vjeç: 2.5 ml shurup një herë në ditë. Përdorni lugën matëse deri në 2.5 ml.

Fëmijët e moshës nga 6 deri 11 vjeç: 5 ml shurup një herë në ditë. Përdorni lugën matëse deri në 5 ml.

Të rriturit dhe fëmijët 12 vjeç e sipër: 10 ml shurup një herë në ditë (dozë ditore) Përdorni lugën matëse deri në 5 ml dy herë në ditë

Mjeku juaj do të përcaktojë llojin e rinitit alergjik dhe të vendosë kohëzgjatjen e trajtimit tuaj me ALRINAST.

Nëse keni rinit alergjik sporadik (prania e simptomave për një kohëzgjatje më pak se 4 ditë në javë, ose për më pak se 4 javë), mjeku juaj do t'ju rekomandojë një plan trajtimi, që do të varet nga vlerësimi i historisë së sëmundjes suaj.

Nëse keni rinit alergjik të vazhdueshëm (prania e simptomave me një kohëzgjatje 4 ditë ose më tepër gjatë javës, dhe për më gjatë se 4 javë), mjeku juaj mund t'ju rekomandojë një trajtim më afatgjatë.

Kohëzgjatja e trajtimit të urtikarieve mund të ndryshojë nga një pacient në tjetër, dhe për këtë arsye, ju duhet të ndiqni udhëzimet e mjekut tuaj.

Rruga dhe mënyra e përdorimit:

Gëlltiteni shurupin, dhe më pas pini një gotë ujë. ALRINAST mund të merret më ushqim ose esëll.

Grupmosha të ndryshme :

Përdorimi pediatrik:

ALRINAST përdoret që prej moshës 6 muaj.

Përdorimi tek të moshuarit :

Siguria dhe efikasiteti i ALRINAST ende nuk është përcaktuar.

Kushtet e veçanta të përdorimit:

Përdorimi në insufiçencën hepatike

Nuk ka të dhëna në lidhje me përdorimin në insufiçencën hepatike

Përdorimi në insufiçencën renale

ALRINAST duhet të përdoret me kujdes në pacientët me pamjaftueshmëri të rëndë të veshkave.

Nëse ju vini re se efikasiteti i ALRINAST është i fuqishëm apo i dobët, konsultohuni me mjekun ose farmacistin.

Nëse ju merrni më shumë ALRINAST se ju duhet:

Merreni ALRINAST vetëm ashtu siç është përshkruar për ju. Nuk priten probleme serioze shkaktuar nga marrja e mbidozës aksidentale.

Nëse ju merrni më shumë sasi të ALRINAST, se sa ju duhet, konsultohuni me një mjek ose farmacist.

Nëse ju harroni të merrni ALRINAST:

Nëse ju harroni të merrni dozën tuaj në kohë, merreni atë menjëherë, sapo t'ju kujtohet, dhe më pas, vazhdoni me orarin tuaj të rregullt të marrjes së dozës.

Mos merrni një dozë të dyfishtë për të zëvendësuar dozën e harruar.

Në goftë se ndërprisni terapinë me ALRINAST:

Nuk ka asnjë efekt të raportuar.

4. Cilat janë efektet e mundshme anësore?

Ashtu si të gjitha barnat, ALRINAST mund të shkaktojë efekte anësore në pacientët me ndjeshmëri ndaj përbërësve të produktit. Në të rriturit, efektet anësore janë të ngjashme me ato të placebo (një medikament jo terapeutik). Megjithatë, efektet anësore të zakonshme tek fëmijët më pak se 2 vjeç ishin diarre, ethe dhe pagjumësi, ndërsa në të rriturit, lodhja, goja e thatë dhe dhimbja e kokës u raportuan më shpesh, sesa trajtimi me placebo.

Efektet anësore të kundërindikuar janë të shënuara sipas kategorive të sistemit organik si më më poshtë. Frekuencat janë të përcaktuara si:

Në klasifikime të ndryshme të sistemit organik;

Shumë të zakonshme ($\geq 1 / 10$); zakonshme ($\geq 1/100$ deri $< 1/10$); pazakontë ($\geq 1/1000$ deri $< 1/100$); rrallë ($\geq 1 / 10.000$ deri $< 1 / 1.000$); shumë të rralla ($< 1 / 10.000$); të panjohura (nuk mund të vlerësohen nga të dhënat në dispozicion).

Të zakonshme: Lodhje

Të pazakonshme: Gojë e thatë, dhimbje koke

Shumë të rralla: Reaksione alergjike (vështirësi në frymëmarrje, fishkëllima frymënxjerrje, kruajtje, urtikarie (irritim), Rash/skuqje, halucinacione, nervozizëm me lëvizshmëri të lartë, palpitacione, përshpejtim të rrahjeve të zemrës, analiza me rezultate jonormale të funksionit të mëlçisë, pezmatim të mëlçisë, marramendje, hiperaktivitet fizik dhe mendor, dhimbje stomaku, të përziera (ndjenja e të vjellit), të vjella, diarre, pagjumësi, të qenët i përgjumur, dhimbje të muskujve, fryrje/gazra.

Nëse vini re ndonjë efekt anësor, i cili nuk përfshihet në këtë fletëpalosje, ju lutem, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. Si ta ruajmë ALRINAST

Ruajeni ALRINAST në paketë dhe mbajeni jashtë kontaktit dhe pamjes së fëmijëve.

Ruajeni ALRINAST në temperaturën e dhomës, nën 30°C

Përdoreni në përputhje me datën e skadimit.

Mos e përdorni ALRINAST pas afatit të skadencës së shënuar në paketë.

Mos e përdorni ALRINAST, në rast se vini re ndonjë dëmtim në produkt dhe/ose paketë.

Mbajtësi i licencës:

İlko İlaç San. ve Tic. A.Ş.

Veysel Karani Mah. Çolakoğlu Sok. No: 10

Sancaktepe / Istanbul, Turkey

Vendi i prodhimit:

Nobel İlaç San. ve Tic. A.Ş. Sancaklar 81100 / Düzce, Turkey